



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3046/3 prot.

Pogradec, më 20.07.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI,
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, *"Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101, datë 31.10.2025 "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026", i ndryshuar.*

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROJEKT - VENDIM
NR. ____ , DATË ____ . ____ . 2026
PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 101, DATË 31.10.2025
“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA
NË TERRITORIN E BASHKISË POGRADEC, PËR VITIN 2026”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 321, datë 28.05.2014, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, i ndryshuar, VKM nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar , si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Të miratojë shtimin e një vendbazimi për varkat e peshkimit në zonën e Mëmëlishtit, Njësia Administrative Hudënisht, si pjesë e Hartës së Përgjithshme të Plazheve të Lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101, datë 31.10.2025, "Për miratimin e Hartës së Përgjithshme të Plazheve të Lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026", i ndryshuar, sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

K R Y E T A R E
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E P. K. ZH.T

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin *"Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101, datë 31.10.2025 "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026", i ndryshuar.*

E nderuar Kryetare e Këshillit!
Të nderuar Këshilltarë !

Ky projekt-vendim mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 28.05.2014, "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", të ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar.

Gjatë zbatimit të Hartës së Përgjithshme të Plazheve për sezonin turistik 2026 është evidentuar nevoja për përcaktimin e një vendbazimi për varkat e peshkimit në zonën e Mëmëlishtit, Njësia Administrative Hudënisht, me qëllim sistemimin e mjeteve lundruese të peshkimit dhe organizimin më të mirë të aktivitetit të peshkatarëve.

Vendbazimi i propozuar nuk cenon funksionimin e plazheve të lejuara dhe kontribuon në përdorimin e rregullt të hapësirës publike bregliqenore, në rritjen e sigurisë dhe në administrimin më efikas të territorit.

Për këtë arsye propozohet plotësimi i Hartës së Përgjithshme të Plazheve të Lejuara me vendbazimin e ri, sipas hartës grafike bashkëlidhur, e cila do të bëhet pjesë përbërëse e vendimit.



Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Në mbështetje të nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.

Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, përcakton se akte me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, të cilat u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, përcaktojnë norma të përgjithshme sjelljeje dhe shtrijnë efektet e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Në zbatim të nenit 8, shkronja "a", të këtij ligji, Prefekti ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi këto akte.

Po kështu, neni 3, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", e përkufizon aktin normativ nënligjor si shprehje të vullnetit të një organi publik që vendos rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe nuk shterohet me një zbatim të vetëm.

Projekt-vendimi "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101, datë 31.10.2025, 'Për miratimin e Hartës së Përgjithshme të Plazheve të Lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026'" ndryshon dhe plotëson një akt normativ ekzistues, i cili rregullon përdorimin e hapësirave publike bregliqenore në territorin e Bashkisë Pogradec.

Me miratimin e tij, projekti plotëson Hartën e Përgjithshme të Plazheve të Lejuara duke shtuar një vendbazim për varkat e peshkimit në zonën e Mëmëlishtit, Njësia Administrative Hudënisht. Ky ndryshim nuk krijon një marrëdhënie juridike konkrete me një subjekt të caktuar, por rregullon organizimin dhe përdorimin e një pjese të territorit të bashkisë, duke prodhuar efekte juridike të përgjithshme, të vazhdueshme dhe ndaj një numri të papërcaktuar subjektësh.

Për rrjedhojë, projekt-vendimi ka natyrë normative dhe, në përputhje me nenin 13, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 dhe nenet 4 e 8 të ligjit nr. 107/2016, i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim!

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Marjano Tasellari


Miratoi: Paskalino Ziko

Konfirmoi: Dritan Babasuli

Përcaktoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik:

Jurist i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit: Taulant Fejzo

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI



Legjenda

Ortofoto 2019 (UAV)

Shtresë Bazë

Parcelat

Ndërtesat

Rendi 3 (Kufi Bashki)


Rendi 2 (Kufi Qarku)

Rendi 1 (Kufiri Tokësor)

Rendi 1 (Kufiri Tokësor)

Rendi 1 (Vijë Bregdeti)

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH



<https://geoportal.asig.gov.al>: ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.